KOLEGJI UNIVERSITAR "REALD"
REKTORATI

Nr. 59 Prot. Vlorë më 20.03.2020

URDHËR
Nr. 32, datë 20.03.2020

"PËR ZHVILLIMIN E PROCESIT MËSIMOR ONLINE NË KOLEGJIN UNIVERSITAR "REALD"

Bazuar në nenin 37 të Ligjit nr. 80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";* në nenet 98 e 99 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë"*; nenin 9, të Statutit të Kolegjit Universitar "Reald", miratuar me Urdhër nr. 147, datë 13.03.2017 të ministrit të Arsimit dhe Sportit; si dhe në Urdhrin nr. 91, datë 09.03.2020, *"Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jopublike",* të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë; si dhe Vendimit nr. 31, datë 09.03.2020, të Senatit Akademik, ***"Për pezullimin e procesit mësimor në Kolegjin Universitar "Reald", nga data 10 – 23 mars 2020 dhe zëvendësimin e tyre në ditët në vazhdim",***

Për arsye të zhvillimit tw procesit mwsimor online, gjatë periudhws sw fatkeqwsisw natyrore (shpallur pwr parandalimit të përhapjes së virusit COVID-19):

URDHËROJ :

1. Perocesi mësimor në të gjitha njësitë kryesore dhe njësitë bazë në Kolegjin Universitar "Reald", të zhvillohet ***online*** në mënyrë virtuale.

2. Zhvillimi i procesit mësimor ***online*** të bëhet duke filluar më datë 24.03.2020 e deri në daljen e një vendimi të dytë për fillimin e procesit mësimor në auditore me prezencë fizike.

3. Procedurat e zhvillimit të procesit mësimor online do të realizohen si më poshtë:

   Çdo pedagog i stafit akademik, sipas ngarkesës së semestrit të II, të vitit akademik 2019-2020:

   a. Përcakton një nga format online të komunikimit në grup, sipas përcaktimeve në këtë urdhër;
   b. Krijon grupin virtual të programit të studimit me studentët e grupit, sipas planit mësimor. Grupi virtual i studimit krijohet me të gjithë, apo më shumicën e studentëve të atij grupi studimi;
   c. Jep udhëzime, materiale, leksione në formate të ndryshme për grupin e krijuar, lidhur me përvetësimin e lëndës përkatëse. Formatet e materialeve mund të jenë në "word", "pdf", "powerpoint", "excel", etj;
   d. U përgjigjet pyetjeve të studentëve për çështje të ndryshme të mësimit;
   e. Jep detyra dhe ushtrime lidhur me lëndët në varësi të veçantive të secilës lëndë;
   f. Ndjek ecurinë e përgatitjes së detyrave të kursit, si dhe të studentëve që po përgatitin tezat e diplomës;
   g. Informon përgjegjësin e njësisë bazë për ecurinë e zhvillimit të mësimit online;
   h. Dokumenton zhvillimin e mësimit në evidencat përkatëse;

4. Sistemet virtuale të komunikimit në grup, për zhvillimin e procesit mësimor online, të zgjidhen nga pedagogët duke marrë në konsideratë interesat e lëndës respektive, si më poshtë:
   - Google Clasroom;

- WhatsApp;
- Viber;
- E-mail;
- Facebook;
- Skype;
- Të tjera.

5. Ngarkohen dekanët dhe përgjegjësit e departamenteve për ndjekjen e zbatimit të këtij Urdhëri.

6. Personeli ndihmës-akademik mbështet dhe lehtëson zhvillimin online të procesit mësimor.

7. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Spiro CAUSHI